

EXPORT ON

Platforma Kombëtare për Fuqizimin e Eksporteve Shqiptare



Më 28 janar 2026, AIDA organizoi ExportON 2026, me pjesëmarrjen e mbi 250 përfaqësuesve të bizneseve eksportuese, institucioneve dhe partnerëve ndërkombëtarë. Eventi shënoi nisjen e një faze të re për eksportet shqiptare, me fokus te cilësia, vlera e shtuar dhe pozicionimi strategjik në tregjet ndërkombëtare.

Kryeministri z. Edi Rama theksoi nevojën për kalimin nga konkurrenca me çmim të ulët drejt standardeve të larta dhe certifikimeve të BE-së, duke e konsideruar procesin e integritimit europian si një mundësi për bizneset që dinë të përshtaten. Roli i AIDA-s u vlerësua si mekanizëm kyç mbështetës për eksportet dhe produktet "Made in Albania".

Drejtoresha e AIDA-s, znj. Laura Plaku, prezantoi fokusin e ri institucional drejt cilësisë dhe tregjeve ndërkombëtare, ndërsa përfaqësuesit e qeverisë theksuan rëndësinë e reformave dhe potencialin e sektorëve prodhues.



Tryeza e Bujqësisë dhe Agrobiznesit | ExportON 2026

Në kuadër të ExportON 2026, u zhvillua Tryeza e Bujqësisë dhe Agrobiznesit, e fokusuar në sfidat dhe mundësitë e sektorit në procesin e integrimit në BE dhe rritjen e eksporteve bujqësore.

Tryeza e Bujqësisë dhe Agrobiznesit u fokusua në sfidat e sektorit në kuadër të integrimit në BE dhe rritjes së eksporteve bujqësore. AZHBR prezantoi skemat e mbështetjes për fermerët deri në vitin 2030, ndërsa Banka e Zhvillimit paraqiti instrumente për përmirësimin e aksesit në financë.

Përfaqësues të institucioneve, shoqatave të sektorit dhe bizneseve diskutuan nevojën për standarde, certifikime dhe instrumente financiare të përshtatura për sektorin. Tryeza u vlerësua si një hap konkret për forcimin e eksporteve bujqësore.



Tryeza e Manufakturës | ExportON 2026

Në kuadër të ExportON 2026, u zhvillua Tryeza e Manufakturës, e cila mbledhi përfaqësues të institucioneve qendrore, autoriteteve rregullatore, sistemit financiar, organizatave të biznesit dhe sipërmarrjeve prodhuese e eksportuese, duke krijuar një platformë gjithëpërfshirëse dialogu mbi sfidat dhe perspektivat e sektorit.

Tryeza e Manufakturës mbledhi përfaqësues të institucioneve, sektorit financiar, organizatave të biznesit dhe industrive prodhuese, për të diskutuar sfidat dhe perspektivat e sektorit.

Diskutimet u fokusuan në çështje fiskale, doganore, kosto energjie, mungesë fuqie punëtore, certifikime dhe standarde të BE-së. Zëvendësministria Olta Manjani theksoi rëndësinë e inovacionit, zinxhirëve të prodhimit me cikël të mbyllur dhe forcimit të infrastrukturës së cilësisë.



AIDA falënderon të gjithë pjesëmarrësit për kontributin e dhënë në këto tryeza.

AIDA mirëpriti Ambasadorin e Mbretërisë së Spanjës

Forcim i marrëdhënieve ekonomike Shqipëri-Spanjë

Drejtoresha ekzekutive e Agjencisë Shqiptare të Zhvillimit të Investimeve (AIDA) zhvilloi një takim me Ambasadorin e Mbretërisë së Spanjës në Shqipëri, z. Gabriel Cremades Venturasi dhe me Këshilltaren Ekonomike dhe Tregtare të Ambasadës së Spanjës në Romë, znj. Pilar Merino Troncoso.

Gjatë takimit u diskutua mbi forcimin e mëtejshëm të marrëdhënieve ekonomike dypalëshe, identifikimin e mundësive për partneritete të reja investimi, si dhe organizimin e aktiviteteve të përbashkëta për promovimin e biznesit dhe investimeve.

Palët theksuan rëndësinë e bashkëpunimit institucional dhe të koordinimit të vazhdueshëm për krijimin e mundësive konkrete për kompanitë shqiptare dhe spanjolle, si dhe zhvillimin e projekteve që nxisin rritjen ekonomike dhe shkëmbimin tregtar.



Eksportet shqiptare, janar-nëntor 2025

Në periudhën janar-nëntor 2025, eksportet shqiptare arritën në 319.3 milionë euro, duke reflektuar një zhvillim të qëndrueshëm dhe një prani të konsoliduar në tregjet ndërkombëtare.

Italia mbetet partneri kryesor tregtar me 42.4% të totalit të eksporteve, e ndjekur nga Kosova (9.5%), Greqia (6.8%), Gjermania (6.5%), Spanja (4.6%), Kina (3.1%) dhe Turqia (1.5%). Rritje të ndjeshme të eksporteve u regjistruan drejt Spanjës (+23.6%), Greqisë (+6.7%) dhe Gjermanisë (+2.3%).

Bashkimi European përfaqëson 73.1% të eksporteve shqiptare, duke konfirmuar orientimin drejt tregut evropian dhe nevojën për diversifikim strategjik. ExportON 2026 shërben si platforma ku do të analizohen këto tregje, do të identifikohen sfidat dhe do të ndërtohen strategji konkrete për zgjerimin dhe forcimin e eksporteve shqiptare.

- 🇮🇹 Itali – partneri kryesor tregtar (42.4%)
- 🇰🇲 Kosovë – tregu i dytë në rëndësi (9.5%)
- 🇬🇷 Greqi – 6.8%
- 🇩🇪 Gjermani – 6.5%
- 🇪🇸 Spanjë – 4.6%
- 🇨🇳 Kinë – 3.1%
- 🇹🇷 Turqi – 1.5%



Eksportet - tendencat kryesore

Transformimi cilësor i eksporteve mbetet një prioritet kyç për zhvillimin ekonomik, me fokus kalimin nga produktet gjysmë të përpunuara drejt prodhimit final dhe forcimin e rolit të Shqipërisë në zinxhirët europianë të furnizimit.

Të dhënat për periudhën janar–nëntor 2025 tregojnë një ristrukturim gradual të portofolit eksportues. Gjatë kësaj periudhe, eksportet e mallrave arritën vlerën 319.3 miliardë lekë, duke reflektuar sfidat e tregjeve ndërkombëtare, por edhe potencialin për rritje të qëndrueshme. Nën mbështetjen e AIDA-s, sektorë me vlerë të shtuar më të lartë, si agro-përpunimi dhe makineritë, kanë shënuar rritje dhe orientim drejt standardeve europiane.

Të dhënat e INSTAT theksojnë nevojën për diversifikim të mëtejshëm të strukturës prodhuese, ndërkohë që konfirmojnë se bazat për një model më të qëndrueshëm dhe konkurrues eksporti po forcohen, falë politikave publike dhe angazhimit të vazhdueshëm të AIDA-s për promovimin e markës “Made in Albania”.

Produktet kryesore të eksportit – Janar–Nëntor 2025

- 🧵 Tekstile & këpucë – 96.6 mld lekë
- ⚡ Minerale, lëndë djegëse & energji – 57.2 mld lekë
- 🍏 Ushqime, pije & duhan – 51.2 mld lekë
- 🏗️ Materiale ndërtimi & metale – 45.0 mld lekë
- ⚙️ Makineri & pajisje – 36.8 mld lekë



Përgatitjet për EXPORT ON | 28 Janar

Gjatë muajit Janar, para eventit të madh, pranë zyrave të AIDA-s, u zhvillua një takim përgatitor me përfaqësues të shoqatave të biznesit dhe dhomave të tregtisë. Gjatë takimit u diskutuan problematikat konkrete që hasin eksportuesit në praktikë, si dhe çështjet prioritare që do të trajtohen në eventin EXPORT ON më 28 janar.

Ky proces konsultimi synon që zëri i biznesit të jetë në qendër të diskutimit, duke ndihmuar në ndërtimin e një axhende tematike që reflekton nevojat reale të eksportuesve dhe nxit zgjidhje konkrete për rritjen e eksporteve shqiptare. EXPORT ON do të shërbejë si një platformë dialogu mes sektorit privat dhe institucioneve publike, për të forcuar bashkëpunimin dhe zhvillimin e eksporteve shqiptare.



Kalendari i Panaireve Ndërkombëtare – Viti 2026!

Zbuloni panairët më të rëndësishme ndërkombëtare të vitit 2026. Një mundësi ideale për biznese, investitorë dhe profesionistë për të krijuar lidhje të reja, për të promovuar potencialin shqiptar dhe për të zgjeruar bashkëpunimet ndërkombëtare.

Qëndroni të informuar dhe planifikoni pjesëmarrjen tuaj në kohë.

Për interes ose informacion mbi pjesëmarrjen në ndonjë nga panairët e publikuara, na kontaktoni në info@aida.gov.al.

Ndiqui kanalet tona për më shumë detaje.



Match-Maker Albania – Edicioni II

Më 26 mars 2026 do të zhvillohet Edicioni i Dytë i Match-Maker Albania, një platformë që synon të lidhë biznesin shqiptar me partnerë dhe tregje ndërkombëtare.

Duke prezantuar Zonën e Pasurive të Ardhshme në Match Maker Albania – Edicioni III!

Kjo hapësirë e dedikuar bashkon projekte me potencial të lartë në pasuri të paluajtshme, mikpritje dhe zhvillim urban në të gjithë Shqipërinë.

-  Zhvillime rezidenciale dhe të mikpritjes
-  Projekte me përdorim të përzier
-  Parqe industriale dhe logjistike
-  Projekte të zhvillimit urban

Bashkohuni me ne për prezantime projektesh, sesione pitch, takime një-për-një me investitorë, zhvillues, arkitektë dhe partnerë ndërkombëtarë, të gjithë me synimin për të nxitur investime, bashkëpunim dhe rritje të qëndrueshme.

 26.03.2026 |  Pallati i Kongreseve, Tiranë

AIDA fton NVM-të dhe startup-et shqiptare të aplikojnë në WIPO Global Awards 2026

Agjencia Shqiptare e Zhvillimit të Investimeve (AIDA) informon ndërmarrjet e vogla dhe të mesme shqiptare, si dhe startup-et inovative, mbi hapjen e aplikimeve për WIPO Global Awards 2026, çmimet e Kombeve të Bashkuara për biznese inovative dhe kreative.


Kjo iniciativë ndërkombëtare synon të vlerësojë biznese që përdorin inovacionin, kreativitetin dhe pronësinë intelektuale për të rritur konkurrueshmërinë dhe për të zgjeruar praninë e tyre në tregjet ndërkombëtare.

Përfitimet për bizneset shqiptare përfshijnë:

- ✓ Njohje dhe vizibilitet ndërkombëtar për produktet "Made in Albania"
- ✓ Mentorim individual 6-mujor për zhvillim dhe komercializim
- ✓ Mundësi lidhjeje me investitorë, partnerë dhe rrjete globale inovacioni

Afati i aplikimit: 15 Janar – 31 Mars 2026
Aplikimi është falas

Për më shumë informacion dhe aplikim:
global.awards@wipo.int



Investimet slovene në Shqipëri janë në rritje

Investimet slovene në Shqipëri janë në rritje!

-2024: vlera më e lartë e stoku: 44 milion € (+7.3% vs 2023)

-Shtator 2025: stoku në 48 milion €, fluksi Janar–Shtator: 4 milion €

Ky trend i rritjes tregon besimin dhe potencialin për partneritete të reja biznesi.

Bashkohuni me ne në Forumin e Biznesit Shqipëri–Sloveni për të lidhur kompani dhe institucione nga të dy vendet:

 Ndërtim |  TIK |  Agro–ushqim |  Inovacione në bujqësi |  Turizëm

 5 shkurt 2026 |  Tirana Innovation Hub
 info@aida.gov.al

Një mundësi e shkëlqyer për të zgjeruar rrjetin dhe për të krijuar bashkëpunime ndërkombëtare!

INVESTIMET SLOVENE NË SHQIPËRI



Vlera më e lartë e stoku:

Viti: 2024

44 milionë Euro

Rritja vjetore:

2024 vs 2023: +7.3 %

Stoku i investimeve në Shtator 2025:

48 milionë Euro

Fluksi për Janar–Shtator 2025:

4 milionë Euro

AIDA ju fton të merrni pjesë në-“INTERNATIONAL JORDAN FOOD EXHIBITION 2026”, Jordani

FTESE PËR PJESËMARRJE NË PANAIRIN NDËRKOMBËTAR “INTERNATIONAL JORDAN FOOD EXHIBITION 2026” 10-14 Shkurt 2026 Aman, Jordani.

Agjencia Shqiptare e Zhvillimit të Investimeve (AIDA) informon kompanitë shqiptare të sektorit ushqimor dhe agro-përpunues mbi mundësinë për të marrë pjesë në edicionin e 10-të të International Jordan Food Exhibition 2026, një nga panairët më të rëndësishme ndërkombëtare të ushqimit në rajonin e Lindjes së Mesme.

Panairi do të zhvillohet në Jordan International Exhibition Center, pranë Mecca Mall – Gate 3, në Aman, dhe do të mirëpresë ekspozues, importues, distributorë, blerës profesionistë dhe përfaqësues institucionesh nga vende të ndryshme.

Sektorët kryesorë të përfaqësuar:

- Ushqime dhe pije
- Agro-përpunim
- Produkte bujqësore
- Teknologji dhe pajisje për industrinë ushqimore

Panairi ofron:

- Takime B2B me blerës dhe distributorë rajonalë
- Mundësi konkrete për eksport dhe bashkëpunim tregtar
- Ekspozim në një treg në rritje të lartë për produktet ushqimore

Kompanitë shqiptare ftohen të shprehin interes për pjesëmarrje dhe të përfaqësojnë produktet “Made in Albania” në këtë event ndërkombëtar.

Për informacion të mëtejshëm dhe regjistrim, kontaktoni organizatorin:
International Promoters for Marketing and Organizing Exhibitions (IPCO)

Leen Abu Wandy – Marketing Officer
Email : Leen@ipcojo

Ahmad Almasri – Marketing Manager
Email : ahmad@ipcojo

Për më shumë informacion mund të vizitoni faqen zyrtare të panairit:
<https://jordanfood-expo.com/>



AIDA ju fton të merrni pjesë në “MACFRUT Rimini 2026

MACFRUT, panairi kryesor ndërkombëtar i zinxhirit të frutave dhe perimeve, do të zhvillohet në Rimini (Emilia-Romagna, Itali) nga data 21 deri më 23 Prill 2026.

Ky aktivitet mbledh bashkë kompani ndërkombëtare, blerës, furnitorë dhe vendimmarrës, duke mbuluar të gjithë zinxhirin e vlerës: para-korrjes, pas-korrjes dhe ushqimin e shëndetshëm. Panairi paraqet një mundësi kyçe për krijimin e partneriteteve dhe takimeve B2B me ekspozues nga rajoni Emilia-Romagna.

Takimet B2B do të zhvillohen në gjuhën angleze në standat e ekspozuesve.

Pjesëmarrësit kërkohet të mbërrijnë më 20 ose 21 prill dhe të garantojnë minimum 4 takime në ditë.

Shërbimet falas të ofruara:

- ✓ Akomodim në hotel (2-3 netë)
- ✓ Biletë hyrjeje në panair dhe akses në Buyers' Lounge
- ✓ Shërbime shuttle (aeroport ↔ hotel ↔ panair)
- ✓ Business matching përmes platformës digjitale të MACFRUT-it

Kompani të interesuara për pjesëmarrje mund të regjistrojnë Shprehjen e Interesit në:

<https://buyer.macfrut.com/mvc/registration?i=OtSnH64s9JY=>

Expression of Interest for Participation

OPEN CALL FOR COMPANIES BASED IN ALBANIA

EXPRESSION OF INTEREST FOR COMPANY MISSION
OPEN CALL FOR COMPANIES INTERESTED IN FRUIT & VEGETABLE TECHNOLOGIES
MACFRUT 2025 - RIMINI, ITALY | APRIL 21-23

Participation from Albania is Required

Main Topics of Emilia-Romagna Exhibitors:

- Machines and Technical Equipment for the field (pre-harvest)
- Irrigation systems
- Machines and Technologies for post-harvest (selection lines, packaging and preservation)
- Packaging: materials and packages for fruit and vegetables
- Refrigeration systems.

WHO CAN PARTICIPATE?

- Companies in the fruit & vegetable supply chain (pre-harvest, post-harvest, Healthy Food)
- Buyers and decision makers interested in sourcing Italian technologies and solutions
- Organizations willing to participate in B2B meetings (minimum 4 per day) and meet Emilia-Romagna exhibitors

FREE OF CHARGE SERVICES

- Hotel accommodation for 2 nights
- Entry ticket at Macfrut fair 2026 and access to the buyers' lounge
- Participation in B2B meetings
- Free shuttle service from Rimini or Bologna airport
- Free shuttle service to and from Rimini expo centre

REGISTER HERE

More info: <https://www.macfrut.com/en/>

AIDA ju fton të merrni pjesë në Workshop Online

Agjencia Shqiptare e Zhvillimit të Investimeve (AIDA), me mbështetjen e GIZ Albania dhe ekspertizën e Damiani & Partners, organizon më 21 Janar 2026, ora 11:00, një Workshop Online me temat:

“Njohuri mbi platformat, instrumentet dhe mekanizmat që duhen ndjekur për të hyrë në tregje të reja”

“Gatishmëria për Eksport”

Ftohen të gjitha bizneset e sektorit të Ushqimit dhe Pijeve të bëhen pjesë e këtij workshop-i online, për të përfutur njohuri të reja dhe për të rritur praninë e tyre në tregjet ndërkombëtare.

Linku i workshop-it:

https://teams.microsoft.com/l/meetup-join/19%3ameeting_MzlmYzEwZjgtZTc5Yi00NTILWJiZTYtZmMwZjQwNjJlMzMw%40thread.v2/0?context=%7b%22id%22%3a%22f5d8b812-606a-42ba-8cf9-3371cfe29c72%22%2c%22oid%22%3a%22bf0e7f37-7941-42ad-88b7-85261fc90df4%22%7d

Ftesë për pjesëmarrje!

Workshop Online me temat:

- ▶ “Njohuritë mbi platformat, instrumentet dhe mekanizmat që duhen ndjekur për të hyrë në tregje të reja”
- ▶ “Gatishmëria për Eksport”

Ftohen të gjitha bizneset e sektorit Pije dhe Ushqim të bëhen pjesë

21 Janar 2026 ora 11:00

AIDA fton bizneset shqiptare të bëhen pjesë e Misionit të Biznesit në Tokio, Japoni.

Ky mision përfaqëson një mundësi konkrete për të prezantuar kompaninë tuaj në tregun japonez, për të krijuar kontakte të reja biznesi dhe për të eksploruar potencialin e bashkëpunimit me kompani japoneze, veçanërisht në sektorët e energjisë, infrastrukturës dhe shërbimeve.

Bizneset e interesuara janë të ftuara të shprehin interesin e tyre duke kontaktuar në adresën e emailit info@aida.gov.al, deri më 23 janar 2026.

Për çdo informacion shtesë, ju lutemi na kontaktoni.

AIDA invest in Albania

Misioni i Biznesit në Tokio

AIDA ju fton të merrni pjesë në Expo Riva Schuh & Gardabags 2026, Riva del Garda

Ftesë për pjesëmarrje në Expo Riva Schuh & Gardabags 2026, që do të zhvillohet në Riva del Garda, Itali në datat 10–13 Janar 2026

Agjencia Shqiptare e Zhvillimit të Investimeve (AIDA) fton kompanitë shqiptare të industrisë së këpucëve, lëkurës dhe aksesorëve, të marrin pjesë në Expo Riva Schuh & Gardabags 2026, një nga panairët më të mëdha ndërkombëtare të këtij sektori, që do të zhvillohet në Riva del Garda, Itali në datat 10–13 Janar 2026, me prezencë fizike ose digitale në platformën Digital Connection, për kompanitë që nuk mund të shkojnë personalisht.

Në edicionet e fundit, panairi ka mbledhur mbi 1200 kompani ekspozuese nga rreth 41 vende dhe ka tërhequr 8,000–9,000 vizitorë profesionistë nga mbi 100 vende të botës, përfshirë blerës të mëdhenj, distributorë dhe operatorë të industrisë. Pjesëmarrja e gjerë ndërkombëtare dhe rritja e vazhdueshme e interesit nga tregjet europiane dhe globale e bëjnë Expo Riva Schuh & Gardabags një platformë strategjike B2B për promovimin e produkteve, krijimin e partneriteteve dhe zgjerimin e eksporteve për kompanitë e sektorit.

Pse të merrni pjesë?

- ✓Prezantoni produktet tuaja para blerësve dhe partnerëve ndërkombëtarë.
- ✓Zgjidhni mundësi të reja biznesi dhe eksporti.
- ✓Ndërtoni partneritete me kompani nga mbi 100 vende pjesëmarrëse
- ✓Përfutni nga Digital Connection, platforma virtuale për networking, takime dhe katalogë produktesh online

Për më tepër informacion rreth panairit, vizitoni faqen zyrtare <https://exporivaschuh.it/en>, ose kontaktoni organizatorët në postë elektronike: info@exporivaschuh.it ose ☎ +39 0464 570 153.

CRAFTING THE FUTURE OF FOOTWEAR

10 - 13 January 2026
Riva del Garda - Italy